



3/12 KBL
2.3.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT LUMOR ERZEN

VENDIM

Nr. 4, datë 19.02.2026

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT "AREDO STONES"
SH.P.K, ME VENDNDODHJE: FSHATI QERRET, NJ. ADM GOLEM,
BASHKIA KAVAJË, QARKU TIRANË.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit "Aredo Stones" sh.p.k., me vendndodhje: Fshati Qerret, Nj.Adm Golem, Bashkia Kavajë, Qarku Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujqor (pus-shpimi):

- X= 460773.849
- Y= 4563969.103
- Z= 10 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 0.5 \text{ l/sek}$
- Qëllimi i përdorimit: Për qëllime industriale dhe procese teknologjike (Prerje materiale, mermer, granit dhe larje makinerish).
- Thellësia e pus-shpimit: 90 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 40 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit:

$X = 460763.455;$

$Y = 4563963.747;$

$Z = 9 \text{ m}$

- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.1 \text{ l/sek}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL ERZEN

SHKËLQIM HAJDARI

